



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-280

30.08.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për media (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13 dhe 13/14), pikat 6 dhe 10 të Udhëzimit për përmbushje të detyrimit për impresium dhe informacioneve të qasshme për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1, datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-3037/1 datë 1.8.2023 dhe Konkluzionin nr. 02-3274/7, datë 29.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 28-të mbajtur në 29.8. 2023 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, për shkelje të kryer të nenit 14 nga Ligji për media (LM), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar në 7 korrik 2023, në pjesë të programeve të transmetuara nuk ka publikuar të dhënat për impesium që është i detyruar t'i transmetojë në vend e duhur për çdo përmbajtje të veçantë të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-3037/1 datë 1.8.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti të harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara me nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi () të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, gjithashtu zbatohen dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme në vend të dukshëm(duhur) për çdo bartës të përmbajtjes individualisht (për shembull, mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të siguron shpallje të të dhënave në vijim: emrin dhe adresë të selisë

dhe redaksisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur bëhet fjalë për media të shtupit. Për transmetuesit, detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizuale. Botuesi i medias është i detyruar të publikojë në vend të duhur për çdo përmbajtje këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të fragmentit të publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të firmës bartëse që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të mediave të shtypit dhe programeve në radio, data e produksionit (muaji dhe viti) nëse kemi të bëjmë me vepra audio/audiovizuale, origjinën e veprave audio/audiovizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga pruksion i pavarur dhe informacione për të, emri i personi juridik, gjegjësisht emrin dhe mbiemrin ei personit që e ruan të mirën e shfrytëzuar kulturore ose vepër arkivore, gjegjësisht riprodhimin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë fragmenti i programit ose klipi nga bashkëngjitja ose fragmenti i programit, përveç rasteve kur është rregulluar ndryshe me marrëveshje të ndërsjellë.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacione të qasshme për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, për programet e tjera të prodhimit vendor (vetjak), impresiumi publikohet si më poshtë: në shpicën hyrëse ose dalëse (të prezantimit ose mbylljes) publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku e ka origjinën programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkautorëve, pra i gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizuale; emrin e subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, bashkëprodhuesit, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi) dhe datën e produksionit (muaji dhe viti). Nëse është e aplikueshme, duhet të publikon të dhënat edhe për: emrin e personit juridik, gjegjësisht, emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirën kulturore ose veprën arkivore të shfrytëzuar, pra riprodhimin e veprës dhe emrin e subjekti tjetër nga i cili është marrë fragmenti i caktuar ose pjesë fragmenti, përveç rasteve kur me marrëveshje të përbashkët është rregulluar ndryshe.

Në pikën 10 të udhëzimit të sipërpërmendur, parashikohet që gjatë transmetimit të programeve nga prodhues të huaj, televizioni duhet të transmetojë shpicën origjinale.

Në kuadër të kompetencave, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 31 korrik 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, transmetuar më 7 korrik, 2023 nga ku u konstatua shkelje e nenit 14 të LM. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja u konstatoi se në pjesë të programeve të transmetuara më 7 korrik 2023, nuk janë publikuar të dhënat për identifikimin e autorëve që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes audiovizuale, për bartësit e të drejtës së autorit, për redaktorin/redaktorët përgjegjës të programit, për origjinën dhe datën e produksionit të veprave audiovizuale, emrin e mediumit nga i cili është shkarkuar përmbajtja. Ndryshe nga pikat 6 (impresium për programet me prodhim vendor) dhe 10 (impresium për programe me prodhim të huaj) të Udhëzuesit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion të qasshëm për shfrytëzuesit, pa impresium janë transmetuar emisione aktuale-informuese, emision informativ nga fusha e artit, emisione dokumentare, reportazhe, program artistik për fëmijë, inçizim nga ndeshje futbollit dhe inçizime nga koncerte. Këto janë të dhëna që transmetuesi është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur (të përshtatshëm) për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar me datë, titull të emisionit, periudhën e transmetimit (fillim dhe mbarim) dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.10-3037/1 datë 1.8.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, më 8.3.2023, dërgoi Shkresë Nr ynë.ark.10-3037/2 datë 8.3.2023 me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-3037/1 datë 1.8.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të Shkresës, drejtuar Këshillit të [Agjencisë të dorëzon deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 7.8.2023 . Në afatin e paraparë SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 29.8.2023, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe është konstatuar që SHTR K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë t'i shqiptohet masa – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 6 dhe 10 të Udhëzimit për përmbushje të detyrimeve për impresium dhe informacione të qasshme për shfrytëzuesit, pikat 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit të veprimit ndaj aktvendimeve të Agjencisë për ndë marrje të masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-3037/1 datë 1.8.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3274/7 datë 29.8.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur më 29.8.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të

përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit. Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-3037 /1 datë 1.8.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrative paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.